

**SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ELEKTRO-SERVIS SH.P.K.**  
**RR. SHKËLQIM FUSHA, LAGJJA SELITË,**  
**PALLATI MATRIX KONSTRUKSION, KATI 0, FARKË, SELITË, TIRANË**  
**K81313011R**

---

**VENDIM NR. 8**  
**I**  
**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot, më 16.12.2019, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Elektro-Servis Sh.p.k.**, me adresë në Rr. Shkëlqim Fusha, Lagjja Selitë, Pallati Matrix Konstruksion, Kati 0, Farkë, Selitë, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "**Shoqëria**"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

1. "**Balfin**" **Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 90% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k.;
2. **Z. Juljan Mane**, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, më 15.01.1977, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028907609, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i Shoqërisë dhe zotëruar në masën 10% të kapitalit të Shoqërisë;
3. **Znj. Luizita Voda**, në cilësinë e asistentit ligjor të shoqërisë Balfin Sh.p.k.

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Ada Gramatiku, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

**I. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë.**

\*\*\*\*\*

Kryetari i Asamblesë në lidhje me pikat e mësipërme të rendit të ditës, parashtrohet sa më poshtë:

Në lidhje me pikën e parë dhe të vetme në Rend të Ditës Kryetari i Asamblesë parashtrohet se, ortakët kanë vlerësuar që të zvogëlojnë kapitalin e Shoqërisë, i cili është aktualisht në vlerën 85.100.000,00 LEK (tetëdhjetë e pesë milion e një qind mijë Lekë). Ortakët dëshirojnë të zvogëlojnë kapitalin e Shoqërisë me një vlerë të barabartë me 15,195,000 LEK (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë Lekë), vlerë e cila do të ndryshojë kapitalin e Shoqërisë në vlerën e re të barabartë me 69'905'000.00 LEK (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesë mijë Lekë).

Me zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë ortakët e Shoqërisë do të zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë, vlerat e kapitalit në përputhje me sa më poshtë:

**Balfin Sh.p.k. -** do të zotërojë **62,914,500 LEK (gjashtëdhjetë e dy milion e nëntëqind e katërbëdhjetë mijë e pesëqind Lekë)**, të cilat përbëjnë **90%** të kapitalit të zmadhuar të Shoqërisë;

**Juljan Mane -** do të zotërojë **6,990,500 LEK (gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind Lekë)**, të cilat përbëjnë **10%** të kapitalit të zmadhuar të Shoqërisë.

Ortakët bien dakord që kontributi i ortakëve do të paguhet nga Balfin Sh.p.k. edhe për pjesën e ortakut Juljan Mane, pa ngarkuar këtë të fundit me asnjë detyrim ndaj ortakut Balfin Sh.p.k. Ortakët parashikojnë të paguajnë të gjithë vlerën e kontributit në kapital të Shoqërisë, brenda vitit kalendarik 2018.

*Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Ortakët:*

**VENDOSËN:**



- I. Të miratojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me një vlerë të barabartë me 15,195,000 LEK (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë Lekë), vlerë e cila do të ndryshojë kapitalin e Shoqërisë në vlerën e re të barabartë me 69'905'000.00 LEK (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesë mijë Lekë).
- II. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për pasqyrimin e këtij vendimi në Regjistrin Tregtar, ose të autorizojë persona të tjerë për këtë qëllim.

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30. Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakëve të "Elektro-Servis" SHPK mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

\*\*\*\*\*

**Listë - prezenca në Asambleshë e Përgjithshme të Shoqërisë Elektro-Servis shpk datë 16.12.2019**

	<b>Emër, Mbiemër</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Detyra ne Asamble</b>	<b>Firma</b>
1.	<b>"Balfin" Sh.p.k. përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka</b>	Ortak	Kryetare	
2.	<b>Z. Juljan Mane</b>	Ortak	Pjesëmarrës	
3.	<b>Ada Gramatiku</b>	Konsulent Ligjor	Sekretar	